



LajmetOperacionet

14/06/2022

Tiranë – Finalizohet operacioni i koduar “Processing”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve

Operacioni, i zhvilluar nga Komisariati i Policisë Nr. 6.

Sekuestrohen lëndë dhe bimë të dyshuara narkotike cannabis sativa, qese që shërbejnë për ndarjen e lëndës narkotike në doza, krehër dhe municion luftarak.

Vihen në pranga babë e bir, procedohet penalisht në gjendje të lirë djali tjetër.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërisë, bazuar dhe në informacionet e marra në rrugë operative, organizuan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Processing”.

Si rezultat i këtij operacioni u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

– Zh. M., 47 vjeç dhe F. M., 21 vjeç (babë e bir), për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, “Kultivimi i bimëve narkotike” dhe “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, kryer në bashkëpunim.

Gjithashtu, u procedua penalisht në gjendje të lirë djali tjetër, shtetasi M. M., 16 vjeç.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtyre shtetasve, në rrugën “Hamdi Cenoimeri”, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa, bimë të dyshuara narkotike cannabis sativa, të mbjella në tokë dhe në vazo, qese që shërbejnë për ndarjen e lëndës narkotike në doza, krehër dhe municion luftarak.

Këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, pasi i kultivonin bimët narkotike në banesën e tyre, e përgatitnin lëndën narkotike në doza, të cilat i shisnin më pas në zona të ndryshme të qytetit të Tiranës.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Share

Share

Share

Share

Email

◀ Drejtori i FBI-së Christopher Wray mirëpriti në takim Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Gledis Nano

Elbasan – Goditet një rast i shpërndarjes së lëndëve narkotike në doza ▶

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent